



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE



RCT MEMORANDUMI PËR POLITIKA

implementing partners



- Policia e Kosovës
- Qeveria e Kosovës dhe institucionet vendore
- Përfaqësues të BE-së dhe SHBA-së
- Media
- Partitë politike
- Aktorë të shumtë

Tensionet e shumta në veri të Kosovës kanë ndikuar negativisht në marrëdhëniet ndërmjet dy komuniteteve më të mëdha etnike të Kosovës - shqiptarëve dhe serbëve. Në Rajonin e Mitrovicës, ku efektet pozitive të Dialogut në normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë kanë qenë më të dukshmet, janë shfaqur tendenca shqetësuese të rënies së ndjeshme të kontakteve dhe bashkëpunimit ndëretnik. Kjo mund të nxisë më shumë keqkuptime dhe tjetërsim të mëtejshëm, gjë që mund të rrezikojë paqen e brishtë.

Për më tepër, cilësia e marrëdhënieve ekzistuese ndëretnike mbetet e pakënaqshme, e bazuar kryesisht në kontakte sipërfaqësore transaksionale dhe të lidhura me punën, me pak gatishmëri të komuniteteve për t'i thelluar ato. Parakushti kryesor për këtë është krijimi i një atmosfere ku të gjithë qytetarët do të ndihen të barabartë.

Për të parandaluar përkeqësimin e mëtejshëm të marrëdhënieve ndëretnike dhe rrezikun e një konflikti të armatosur lokal, është e nevojshme që aktorët e ndryshëm të ndërmarrin veprime të vendosura. Komuniteti shqiptar në Kosovë vendos përgjegjësinë për zbutjen e tensioneve në dorë të Qeverisë së Kosovës dhe bashkësisë ndërkombëtare të pranishme në Kosovë. Në anën tjetër, komuniteti serb i Kosovës shikon drejt Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Serbisë për hapat në drejtimin e duhur.

Disa nga këto hapa, shumë prej të cilëve tashmë janë obligim i institucioneve, përfshijnë:

01 Dialogu social

Përfaqësuesit politikë të komuniteteve të ndryshme në Kosovë duhet të marrin përsipër përgjegjësinë për dialogun ndërmjet komuniteteve në të gjitha nivelet – lokale, qendrore, qeverisëse dhe opozitare. Për më tepër, liderët politikë duhet të angazhohen seriozisht në konsultimet e brendshme për dialogun e normalizimit për të rritur përgjegjësinë dhe mbështetjen për kauzën.

Bllokimi politik në dialog dhe krizat që pasuan po sfidojnë arritjet e deritanishme të Dialogut. OSHC-të, mediat, akademia dhe palët e tjera të interesuara duhet t'i kundërshtojnë këto tendenca dhe të punojnë më shumë për të vërtetuar rëndësinë e Dialogut dhe arritjet e tij, duke përfshirë proceset e mëparshme integruese si decentralizimi.

Udhëheqësit politikë shpesh krijojnë një mjedis të favorshëm për shtimin e tensioneve etnike përmes deklaratave publike dhe gjuhës së përdorur; prandaj, ata duhet të përmbahen nga diskursi polarizues dhe të promovojnë mesazhe pajtimi që frymëzojnë mirëkuptimin dhe bashkëpunimin ndërmjet komuniteteve. Prandaj, ne sugjerojmë që liderët politikë të rrisin angazhimet publike që promovojnë mesazhe afirmative për bashkëpunim ndëretnik.

Raportimi mediatik në shqip/serbisht duhet të përpiqet të përkthejë folësit serbë/shqiptarë përmes titrave në vend të sinkronizimit të zërit, për të promovuar pranimin e gjuhës dhe shkëmbimin kulturor.

Mediat duhet të mbështesin gazetarët e tyre në mësimin e gjuhëve zyrtare të Kosovës.

Ftojmë BE-në të shtojë përpjekjet për bashkëpunim me shoqërinë civile dhe aktorë të tjerë, përfshirë rininë e marginalizuar, për të promovuar narrativa afirmative në lidhje me Dialogun për normalizimin.

Komuniteti ndërkombëtar duhet të rrisë marrëdhëniet ndërlidhëse me rajonet jashtë Prishtinës, veçanërisht me Rajonin e Mitrovicës, ku angazhimi i shtuar ndodh vetëm gjatë krizave të sigurisë.

02 Shërbimet

Qeveria e Kosovës duhet të adresojë nevojën urgjente për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve komunale në disa komuna të Rajonit të Mitrovicës, duke përfshirë ofrimin e shërbimeve në të gjitha gjuhët zyrtare, lokale apo kombëtare.

Qeveria e Kosovës duhet të rishikojë mandatin e Zyrave Komunale për Komunitete dhe Kthim për të rritur resurset dhe kapacitetet e këtyre zyrave për t'iu përgjigjur më mirë nevojave të komunitetit.

Siguria

Policia e Kosovës, përmes një dialogu në komunitet, duhet të zbusë perceptimet mbizotëruese negative për punën e saj në mesin e komunitetit serb të Kosovës deri në kthimin e oficerëve serbë në forcën policore të Kosovës.

Duke qenë se Kosova është një vend multietnik, Policia e Kosovës, si institucion, duhet, pa kufizime gjeografike, të angazhohet për zhvillimin sistematik të kapaciteteve për angazhimin e komuniteteve dhe mësimin e gjuhëve.

Të dy palët e interesuara, vendase dhe ndërkombëtare, duhet të dyfishojnë përpjekjet e tyre për të siguruar një mjedis të sigurt për gazetarët dhe për të nxitur dhe përforcuar kapacitetin e tyre për të raportuar mbi pajtimin në një mënyrë që do të pasqyronte ndikimin e tij pozitiv, veçanërisht përmes historive pozitive dhe të suksesshme.

Bashkëpunimi ekonomik

Të gjitha programet e mbështetjes të ofruara nga qeveria, si ekonomike ashtu edhe sociale, duhet të riorganizojnë bashkëpunimin ndëretnik, ndërkomunal dhe rajonal për të nxitur kontaktet ndëretnike dhe për të zhvilluar lidhjet e biznesit. Ministria për Bashkëpunim Rajonal duhet ta marrë këtë përgjegjësi. Përveç kësaj, qeveritë e Serbisë dhe Kosovës duhet të mbështesin shkëmbimet rinore.

Kosova dhe Serbia duhet të heqin të gjitha barrierat tregtare në shkëmbimin e mallrave dhe shërbimeve.